



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XVI-të (gjashtëmbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 06 dhjetor 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 10:05.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkollli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Liman Zeqiri shëf i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të UNMIK-ut, (lista e pjesëmarrësve)

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe iu dëshiroj punë të mbarë, ndër të tjera, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë të gjithë, andaj në vazhdim po i lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim rendin e ditës.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 03.11.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësime ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 03 nëntor 2023.

2. Informatë e Njësitit për të Drejtat e Njeriut, rreth fushatës njëmuore për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore që është bërë nga data 18.10.2023 deri më 18.11.2023.

z.Liman Zeqiri, shëf i Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, theksoi, paraprakisht ju informojë se Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Zyrtarja për Barazi Gjinore kanë pas një takim tjetër në Nivel Qendror rreth nismës së të rinjve për të drejtat e njeriut për grupet e marginalizuara, takim në të cilin në kuptim të gjerë të shoqërisë dhe fjalën kryesore e kanë krerët shtetëror dhe ambasadori i SHBA-ve, megjithatë unë kam qenë në mekanizmin e temave që janë në diskutim dhe mund të jap informacione sepse kam qenë pjesëmarrës i atyre takimeve. Sa i përket kësaj pike, fushata ka qenë e organizuar nga niveli nacional prandaj është dashur t'i përmbahen edhe institucionet lokale në koordinim me MPB-në, rolin kryesor në këtë fushatë vetëdijësuese e kanë pas Njësitit për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me Zyrtarët për Barazi Gjinore, mekanizmi lokal veprues për parandalimin e kësaj dukurie devijante, thjeshtë për sensibilizim sepse është fushatë për ndërgjegjësimin e njerëzve sidomos të të rinjve kur dihet se në kohën që po jetojmë është çështje delikate kjo, por ne që jemi edhe më të moshuar e kemi obligim që të kujdesemi për të rinjtë tanë që mos t'i lejojmë t'i qasen dukurive negative, andaj ne e kemi për obligim që të mbajmë fushata vetëdijësuese dhe t'ju tregojmë rreziqet e dukurive negative siç është trafikimi me qenie njerëzore e të tjera të ngjashme.

Mund ta them se trafikimi me qenie njerëzore është një dukuri globale ku në këto rrethana edhe ne si institucione duhet të mbajmë ligjëratat vetëdijësuese nëpër institucione e sidomos nëpër shkollat tona dhe këtë fushatë dhe veprimet t'i bëjmë së bashku me Njësitë për të Drejtat e Njeriut, Zyrtarin për Barazi Gjinore, Qendrën për Punë Sociale, Policinë, Institucionet Lokale Përgjegjëse, Zyrën Komonale për Komunitete dhe Kthim, Drejtorinë komunale të Arsimit, OJQ të ndryshme, pra këto si mekanizma adekuat.

Pastaj kemi Komitetin Komunal Veprues i cili merret me çështjet e parandalimit të dukurive negative, megjithatë ne të gjithë duhet të bëjmë gjithçka që është e mundur për parandalimin e dukurive negative, dhe atë me vullnet dhe angazhim, por është edhe detyrë që ne duhet të përkujdesemi. Fushata vetëdijësuese është hapur më datë 20.10.2023 në këtë sallë dhe kanë marrë pjesë në takim rreth 40 persona e që në kuadër të kësaj kanë qenë edhe përfaqësues të OJQ-ve si dhe përfaqësues të institucioneve lokale.

Pasatja kanë filluar takimet nëpër shkolla dhe më 06.11.2023 është mbajtur takimi në SHMFU "Dëshmorët e Kombit", me klasët XI-ta deri në të IX-ta, dhe në kuadër të kësaj kanë marrë pjesë Koordinatori i Njësitit për të Drejtat e Njeriut, Zyrtari hetues policor, përfaqësuesit e Qendrës për Punë Sociale si dhe mekanizmat tjerë institucional të cilët e sqaruar qëllimin e fushatës rreth vetëdijësimit nga rreziku që paraqitet fenomeni i trafikimit të qenieve njerëzore, mënyrën se si duhet të monitorohet dhe luftohet kjo dukuri devijante. Mandej rreth kësaj teme janë mbajtur takime të rregullta edhe me SHML në qytet dhe në SHMU të Komunës së Podujevës.

Fushatat janë financuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim edhe me institucionet komunale. Normalisht në këtë kanë luajtur rol edhe grupet e Shoqërisë së marginalizuar ta them kështu në aspektin pozitiv sepse ndihmojnë në këtë drejtim.

Pra unë e kisha si obligim dhe përgjegjësi të raportoj për këtë informatë në emër të Njësitit për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore, për arsye se zyrtarët përkatës janë të ngarkuar me punë dhe detyra tjera të punës dhe nuk kanë mundur të jenë prezent sot në këtë mbledhje.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë unë e falënderoj shumë z.Liman Zeqirin i cili e bëri këtë informatë, mirëpo lidhur me këtë kam një porosi edhe për anëtarët e Komitetit për Komunitete që janë prezent këtu, sidomos atyre anëtarëve që vijnë nga radhët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptas që në lagjet e tyre ku jetojnë ta bëjnë një fushatë të tillë duke filluar nga familjet e tyre sepse kjo është një fushatë vetëdijësuese që ka të bëjë me trafikimin e qenieve njerëzore, e për këtë duhet të njoftohen sidomos fëmijët tanë, prandaj ju lus që në lagjet e juaja të zhvillohet një fushatë e tillë.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e konstatoj të përfunduar diskutimin rreth kësaj pike të rendit të ditës.

3. Informatë e Njësitit për të Drejtat e Njeriut, lidhur me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për periudhën 2023-2026

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, si duket në mungesë të zyrtarit përkatës fjalën sërish duhet t'ia kalojmë z.Liman Zeqirit shef i ZKKK në Podujevë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, unë kam qenë pjesë e këtij plani lidhur me Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje për periudhën 2023-2026. Strategjia i përket nivelit nacional që është e koordinuar me njësitë që merren me këtë strategji e që janë Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Drejtësisë si dhe Ministrinë tjera përgjegjëse si dhe gjithë mekanizmat tjerë relevant.

Normalisht se Strategjia është një dokument i rëndësishëm për ata edhe quhet dokument nacional që miratohet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, pastaj merr dritën e gjelbër për realizimin e planeve të veprimit. Strategjia është për vitin 2022-2026 dhe në kuadër të saj tani hyn edhe Plani i veprimit i cili është detyrë apo mekanizëm i nivelit lokal që çdo Komunë duhet ta hartojë. Muajt nëntor - dhjetor njihen si muajt të fushatave vetëdijësuese dhe këtu dua të bëj një sqarim sepse plani i veprimit lokal është një draft dokument që bazohet në kuadër të Strategjisë ku merren specifikat e Komunës dhe në kuadër të saj është edhe Komiteti Lokal Veprues që organizon debate publike edhe me grupet e interesit sepse dhuna në familje është një fenomen që është në rritje e sidomos dhuna ndaj gjinisë femërore (siç ishte rasti i fundit fatkeq që tronditi shtetin tonë), prandaj ne duhet të luftojmë natë dhe ditë dhe në çdo moment që mos të ketë dhunë, aty ku ka debat, ka dialog, ka komunikim dhe aty nuk mund të ketë dhunë, aty ku ka dhunë duhet të informohen institucionet përgjegjëse siç është Policia, Ministria e Drejtësisë, Gjykatat dhe Prokuroria dhe institucione tjera relevante.

Ne si mekanizëm lokal mund të interferojmë tek organet më të larta shtetërore që të ndalet dhuna në familje e sidomos te gjinia femërore, në kuadër të saj është edhe Plani përkatës i Veprimit në Komunë që është përpunuar nga grupi punues që është Komiteti Lokal Veprues në kundërshtim të cilit bëjnë pjesë Njësitit për të Drejtat e Njeriut, Zyrtarja për Barazi Gjinore dhe mekanizmat tjerë si Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtoria e Arsimit, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim sepse janë sektorë që e përbëjnë atë mekanizmin kryesor shoqëror në Komunën tonë.

Janë mbajtur shumë fushata vetëdijësuese që kanë ndikim edhe në vendet rurale dhe ne si grup kemi apeluar që të kalojmë edhe në fshatin më të skajshëm sepse është shumë normale që në

zonat rurale nuk e kanë informacionin e duhur se ku të drejtohen në rast të paraqitjes së dhunës në familje.

Dhuna në familje vjen prej shumë shkaqeve, ne e dimë se duhet të ketë masa preventive dhe duhet të dihen shkaqet sepse pastaj mund të ketë pasoja. Organet e nivelit qendror merren me pasojat, ne si organe lokale, si shoqëri dhe si komunitet që jemi duhet të bëjmë apel në gjithë shoqërinë dhe ta shtrijmë dorën dhe rrjetin që e kemi që të parandalohet dhuna në familje sepse dhuna shkakton pasoja dhe për të mos ardh deri te dhuna ne duhet t'i kemi informacionet, informacionet janë shkaqet, arsyet janë të mëdha. Ne kemi dalë nga një luftë e tmerrshme ku ende ekzistojnë traumat ku njerëzit si pasojë e saj ende kanë probleme familjare, pastaj janë edhe çështjet ekonomike në kuptimin financiar si dhe problemet tjera psikike e që fatkeqësisht duhet të merremi edhe me këto tema gjithnjë duke u bazuar në faktorin ekonomik, në trauma dhe atë psikologjik si dhe faktorët tjerë që mund të vijnë deri te pasojat, prandaj ne si institucione duhet të merremi me parandalimin e këtyre dukurive.

Dihet se Qendra për Punë Sociale merret me këto raste dhe trajtimin e tyre, prandaj ne e kemi parë të nevojshme që të zhvillojmë fushatë vetëdijësuese për parandalimin e këtyre dukurive, kuptohet se nuk mund të realizojmë fushata vetëdijësuese në çdo muaj ose çdo ditë por ne duhet të punojmë dhe veprojmë për parandalimin e diskriminimit dhe shumë faktorëve tjerë që ende mbahen në heshtje. Shpeshherë ndodh që familja nuk e paraqet rastin por mekanizmat veprues qoftë edhe fqinjët mund ta parandalojnë këtë, në kuptimin e neuropsikiatrisë për parandalimin thuhet se në momentet kur njeriu merr ndonjë veprim e i cili ndoshta mund të jetë veprim makabër ta quaj ashtu e i cili ndoshta mund të zgjatë 5 minuta, dhe nëse dikush arrin ta bind atë person që ta ndalojë atë veprim është normale se ai person kurrë më s'do e ndër marr atë veprim, prandaj këtu ndikon komunikimi, dialogu, mirëkuptimi dhe faktorët tjerë parandalues të dhunës.

Dhuna është fenomen negativ që luftohet nga shtetet më të zhvilluara ekonomikisht por ne gjithmonë duhet të bazohemi në shoqërinë tonë ku jetojmë sepse traditat dhe zakonet tona më parë nuk i kanë lejuar këto dukuri negative sepse kanë bashkëbiseduar, aty ku ndalet bashkëbisedimi dhe komunikimi mund të shfaqet dhuna, andaj për këtë arsye unë kisha thënë se ky është Plan i veprimit dhe Kuvendi i Komunës do ta shqyrtoj dhe miratoj, ne i kemi dhënë sugjerimet, idetë, vërejtje dhe komentet për tu pasuruar sa më shumë si dokument i cili nuk do të thotë se është i përhershëm, mirëpo do të mund të pasurohet gjatë rrugëtimit, prandaj edhe njëherë e përsërisë që ne e kemi për obligim që në bazë të mundësive tona që kemi ta parandalojmë dhunën në mënyrë që mos të shkaktohen pasojat.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe për këtë informatë dhe këto sqarime e falënderoj z.Liman Zeqirin, ne jemi dëshmitarë që çdo herë po rritet dhuna në familje prandaj do të ishte mirë që ne gjithë të angazhohemi sa më shumë për parandalimin e kësaj dukurie, me theks ashtu siç e ceku edhe parafolësi që në rast se kemi ndonjë informatë për dhunë në familje menjëherë duhet ta lajmërojmë atë në mënyrë që mos të vije deri tek më e keqja.

Nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës urdhëroni, nëse jo atëherë e konstatojmë të përfunduar edhe këtë pikë të endit të ditës dhe kalojmë në pikën e radhës.

4. Të ndryshme

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, planin e punës për vitin 2024 nuk e kemi përgatitur, prandaj sot konsideroj se është mirë ta formojmë Grupin punues për përgatitjen e planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024, andaj nëse pajtoheni mund t'i jepni propozimet e juaja.

z.Demokrat Hodolli, propozoj për anëtar të Grupit përkatës punues z.Arbnor Fazliun.

z.Liman Zeqiri, theksoi, është mirë që në kundër dhe kryesues i Grupit të jetë edhe Kryesues i Komitetit për Komunitete, dhe anëtar/e nga komuniteti jo shumicë siç është znj.Shkurte Sejdiu.

Kryesues i Komitetit, propozoj që anëtar i Grupit të jetë edhe z.Selver Rama.

z.Arbnor Fazliu, propozoj që anëtar i Grupit të jetë edhe z.Demokrat Hodolli.

Kryesues i Komitetit, theksoi, nëse nuk ka propozime tjera, atëherë e vë në votim formimin e Grupit punues për përgatitjen e Planit të punës së Komitetit për vitin 2024, sipas propozimeve të paraqitura.

Pas votimit Kryesuesi i Komitetit konstaton se unanimisht nga të gjithë anëtarët e komitetit mbështet formimi i Grupi punues për hartimin e draft planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024 në këtë përbërje; z.Xhafer Ademi-kryesues; znj.Shkurte Sejdiu-anëtare; z.Selver Rama-anëtar; z.Arbnor Fazliu-anëtar; z.Demokrat Hodolli-anëtar.

Si konstatim mbetet që zyrtari i zyrës ligjore t'ua përcjell modelin e planit të punës nga viti i kaluar në mënyrë që anëtarëve të Grupit t'ju lehtësohet puna për hartimin e draft planit të punës për vitin 2024, ndërsa për kohën, vendin dhe datën e takimeve mbetet që njoftimet dhe organizimin ta bëjë Kryesuesi i Komitetit, përmes komunikimit elektronik si dhe telefonik.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, një takim që e kam mbajtur më 20.11.2023 i organizuar nga Zyra për qeverisje të mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, pikë kryesore e diskutimit ishte nxitja dhe promovimi i punësimit për komunitetin RAE, andaj me këtë dua t'ju them se aty është prezantuar promovimi i punësimit nga dy Qendra apo dy institucionet më vitale të shtetit që është Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes, prandaj ju them se konkursi për pranimin e ushtarëve të rinj nga FSK-ja është hapur më 29.11.2023, thirrja është që të aplikojnë sa më shumë të rinj nga radhët e komuniteteve të cekura, si në FSK dhe në Polici, prandaj këtë mesazh e përcolla tek ju që pastaj ta bartni te komunitetet e juaja, kurse informacionet tjera ju mund t'i merrni në kuadër të MPB-së dhe FSK-së.

Ky është një privilegj prandaj ne gjithë së bashku duhet ta ruajmë këtë shtet, apeloj që të jetë numri sa më i madh i atyre që aplikojnë.

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, theksoi, i nderuar z.Liman Zeqiri ju falënderoj për këto informata të rëndësishme dhe ne menjëherë këtë informatë do e përcjellim te komunitetet tona.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komiteti e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:35

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-060/04-0085956/23
Podujevë, 06 dhjetor 2023**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**